



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK
KRYETARI

Nr. 523/1 Prot.

Tiranë, më 18.04.2024

VENDIM

Nr. 21, datë 18.04.2024

**“PËR SHPALLJEN E PERIUdhËS SË VETËKANDIDIMIT PËR ANËTARË TË
KËSHILLIT TË ETIKËS NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”**

Mbështetur në nenin 44 të ligjit nr 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 36 të Statutit të Universitetit të Arteve, në Rregulloren e funksionimit të Këshillit të Etikës të Universitetit të Arteve, miratuar me VSA nr. 23, datë 06.03.2020 si dhe në shkresën nr. 523 Prot., datë 17.04.2024, me lëndë “Mbi përfundimin e mandatit të Këshillit të Etikës” të Juristit të UART,

VENDOSI:

1. Të miratojë fillimin e procedurave të vetëkandidimit për anëtarë të Këshillit të Etikës të Universitetit të Arteve.
2. Periudha e vetëkandidimit për anëtar në Këshillin e Etikës të UART do të jetë **nga dt. 22.04.2024 deri më 24.04.2024** dhe dorëzimi i kërkesës do bëhet **pranë sekretarisë së Senatit Akademik**.
3. Vendimi i përcillet për njoftim drejtuesve të njësive kryesore, të gjithë anëtarëve të Senatit Akademik të Universitetit të Arteve si dhe personelit përgjegjës për informimin e studentëve në fakultet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE DHE INFORMACIONIT/P-A
SEKTORI JURIDIK

Nr. 523 Prot.

Tiranë, më 17.04.2024

Lënda: Mbi përfundimin e mandatit të Këshillit të Etikës

**REKTORIT, UART,
KRYETAR I SENATIT AKADEMIK
Prof. Kastriot ÇAUSHI**

**KRYETARIT TË KËSHILLIT TË ETIKËS,
Prof. Miltiadh KUTALI**

Të nderuar,

Këshilli i Etikës i Universitetit të Arteve, më datë 04.03.2020 ka dalë me Vendimin nr. 1, "Për konstituimin e Këshillit të Etikës të Universitetit të Arteve".

Mbështetur në nenin 36, pika 9 me titull "Këshilli i Etikës", nenin 45, pika 1, gërma "a" të Statutit të Universitetit të Arteve si dhe nenin 5, me titull "Përbërja dhe funksionet" të "Rregullores së funksionimit të Këshillit të Etikës të Universitetit të Arteve", miratuar me VSA nr. 23, datë 06.03.2020, parashikohet se mandati i anëtarëve të Këshillit të Etikës është 4 (katër) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

Për sa më sipër, Ju bëj me dije se mandati i anëtarëve të Këshillit të Etikës ka përfunduar dhe për pasojë duhet të fillojë procesi për rikonstituimin e tij.

Bazuar në nenin 36 të Statutit të Universitetit të Arteve, pikat 5 (pesë) deri në 9 (nëntë), si dhe nenin 5 të Rregullores së KE, Këshilli i Etikës përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë: 1 (një) anëtar i personelit akademik nga kategoria Profesor, përfaqësues nga secili Fakultet, me eksperiencë pune mbi 10 (dhjetë) vite në UART; 1 (një) anëtar përfaqësues i Senatit Akademik të UART nga kategoria Profesor, me eksperiencë pune mbi 10 (dhjetë) vite në UART si dhe (1) një student i UART.

Personat e interesuar për anëtarë të Këshillit të Etikës do të vetëkandidohen dhe në vijim të procedurës, do të zgjidhen nga Senati Akademik i Universitetit të Arteve.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

Adela KUSURI

**SEKTORI JURIDIK
UNIVERSITETI I ARTEVE**